



LILA SHUNDI

PROF. ASSOC. DR.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Prof. As. Lila Shundi është Përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Gjenetikë
- Mikrobiologji Molekulare

EMAIL

dep.mjekesi-tek@umb.edu.al

BIO

Prof. Asoc., Dr. Lila Shundi është diplomuar në vitin 1989 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Në periudhën 1994-1999 ka zhvilluar aktivitetin e saj kerkimor pranë Laboratorit të Epidemiologjisë Molekulare në Institutin Cantacuzino, Bukuresht, Rumani në kuadër të doktoraturës dhe të post doktoraturës. Në vitin 1999, ka marrë gradën “Doktor i Shkencave në Gjenetike”, në Departamentin e Gjenetikës në Fakultetin e Biologjisë të Universitetit të Bukureshtit, Rumani dërsa në vitin 2016 ka mbrojtur titullin shkencor “Profesor i Asociuar”. Në periudhën 2000-2002 ka punuar si kërkuese Shkencore në Departamentin e Mikrobiologjisë së Institutit të Kërkimeve Biologjike, Akademia e Shkencave, Tiranë. Nga viti 2002 është kërkuese shkencore në Institutin e Shëndetit Publik ku ushtron detyrën e Përgjegjëses së Njesisë Bazë të Laboratorëve të Referencës Kombëtare. Ka projektuar dhe vënë në funksion një sërë laboratorësh në fushën e Biologjisë Molekulare në Shqipëri si Laboratori i Mikrobiologjisë dhe Diagnostikës Molekulare në Institutin e Shëndetit Publik, Laboratori i Diagnostikës Molekulare të Sëmundjeve Gjenetike dhe Diagnozës së Paralindjes, pranë Maternitetit “Mbretëresha Geraldinë” në Tiranë, Laboratorin Qendror për Depistimin e Kancerit të Qafës së Mitrës, etj. dhe ka futur për here të pare në Shqipëri: diagnozën molekulare të sëmundjeve infektive për agentë patogjenë si Streptotkoku i grupit A, hepatitet virale, HIV, HPV, Klamidia, Neiseria, etj.; diagnozën e paralindjes për sëmundjet gjenetike si dhe teknikat imunohistokimike për menaxhimin e pacientëve me kancer të gjirit. Dr. Shundi drejton depistimin laboratorik në kuadrin e Programeve Kombëtare për Kancerin. Në fushën e mësimdhënies, që nga viti 2008 është angazhuar në një sërë universitetesh publike dhe private.